

„SONG OF MILOSAOS“ AND THE LAYERS OF FOLK LITERATURE

„KËNGË TË MILOSAOS“ DHE SHITESËZIMET E LETËRSISË POPULLORE

Fatjona ABDULLAHI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: fatjona.abdullahi@unite.edu.mk

Abstract

Jeronim de Rada remains one of the central figures of the Albanian National Renaissance, skillfully intertwining written literature with the rich Albanian folkloric tradition. His work, *The Songs of Milosao*, is one of the masterpieces that embodies this connection, promoting national identity by integrating elements of Albanian cultural heritage. De Rada reflects not only his love for Arbëresh folklore but also his patriotic sentiment, harmonizing folkloric elements with mythological interjections. This paper examines the composition, main themes and motifs, the influence of popular literature, and the mythological elements in his work.

Keywords: Arbëresh heritage, folklore, Albanian literature, mythology. **Abstrakt**

Përmbledhje

Jeronim de Rada mbetet një nga figurat më qendrore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i cili ka gërshtuar mjeshtërisht letërsinë e shkruar me traditën e pasur folklorike shqiptare. Vepra e tij “Këngët e Milosaos” është një nga kryeveprat që simbolizon këtë lidhje, dhe promovon identitetin kombëtar duke integruar elemente të trashëgimisë kulturore shqiptare. De Rada reflekton jo vetëm dashurinë për folklorin arbëresh, por edhe ndjenjën e tij patriotike, duke harmonizuar elementet popullore dhe ndërfutjet mitologjike. Ky punim shqyrton kompozicionin, temat dhe motivet kryesore, ndikimin e letërsisë popullore dhe elementet mitologjike.

Fjalë kyçe: letërsia arbëreshe, folklori, letërsia popullore, mitologjia, trashëgimia shqiptare

Konkretizimi i letërsisë popullore në mes lirizmit dhe rrëfimit

“Këngët e Milosaos” cilësohet si një nga veprat më të arrira të letërsisë shqiptare për shkak të strukturës së saj unike dhe gërshtimit të elementeve epike dhe lirike. Ndërthurja e narracionit me lirizmin krijon një rrjedhë komplekse, ku momente idilike dhe pastorale përshkruajnë jetën dhe peizazhin shqiptar. Kjo veçori e strukturës e bën veprën një reflektim autentik të jetës dhe kulturës shqiptare, duke krijuar lidhje të forta me trashëgiminë popullore.

Fillimi i veprës me kthimin e Milosaos në fshatin e tij, të ndjekur nga konfliktet dhe dashuria e ndaluar me Rinën, e shndërron këtë histori në një alegori të ndarjeve shoqërore dhe aspiratave kombëtare. Ndërthurja e kompozicionit shpesh herë krijon digresione, por gjithnjë nxit zgjidhjen dramatike të konfliktit ndërsa tema kryesore e veprës është ndarja shoqërore dhe

lufta për identitet kombëtar. Konflikti klasor midis aristokracisë dhe shtresës së varfër pasqyron përplasjet e ashpra të kohës, duke përfaqësuar një kritikë ndaj padrejtësive shoqërore (Kodra, 1990). Dashuria e ndaluar midis Milosaos dhe Rinës është një simbol i rezistencës ndaj paragjyqimeve shoqërore, por gjithashtu përfaqëson edhe luftën e brendshme midis dashurisë dhe detyrës ndaj atdheut.

Nuk shkon shumë larg ngjarja, kështu që në këngët e para njihemi me problematikën e shtjelluar në vepër; një djalë i pasur, i rritur në aristokraci dashurohet në bijën e Kallogresë edhe pse “nuk ia do sera”. Keqkuptimet mes tij dhe Rinës, por edhe mes tij e Nënëmadhes sikur na orientojnë në përfundimin e kësaj dashurie dhe rrugëtimin e saj drejt një destinacioni të padëshiruar nga dy të rinjtë. Poezia shpreh fuqinë e lidhjes shpirtërore dhe ndjenjat patriotike, duke i dhënë lexuesit një pasqyrim të pasur të konflikteve të brendshme të personazheve kryesore. Motivet folklorike, si takimet te burimi, vallëzimet dhe peizazhet natyrore, forcojnë lidhjen me kulturën shqiptare.

De Rada integroi figura dhe motive popullore si krahasimi, epitete dhe hiperbola, duke e bërë vargun tetërrokësh një element dominues në vepër (Berisha, 1986). Për shembull, skena e takimit midis Milosaos dhe Rinës në burimin e fshatit dhe thashethemet e grave janë elemente që pasqyrojnë jetën reale të komunitetit arbëresh. Figuracioni i pasur poetik dhe përdorimi i natyrës si sfond për ngjarjet kryesore krijojnë një lidhje të fuqishme me traditën poetike shqiptare. Një nga aspektet më interesante të “Këngët e Milosaos” është përfshirja e elementeve mitologjike dhe imagjinare.

De Rada shpesh përdor mekanizma si ëndrrat dhe tërmetin, i cili luan rolin e *deus ex machina* për të barazuar shtresat shoqërore (Rugova & Hamiti, 1979). Përfshirja e misticizmit dhe elementeve mbinatyrore e pasuron veprën me thellësi filozofike, duke ofruar lexuesit një perspektivë të re mbi ndërthurjen e reales dhe imagjinare. Kodra (1990) thekson se këto elemente jo vetëm që reflektojnë ndikimin e traditës mitologjike, por gjithashtu shërbejnë si simbolika universale për luftën dhe barazinë shoqërore.

Në poemën Këngë të Milosaos, rëndësia e personazheve nuk identifikohet nëpërmjet fjalëve apo vargjeve që dalin nga gojët e tyre por nga ndikimi që ka prezenca e tyre në subjektin e veprës, qoftë në mënyrë aktive qoftë në mënyrë pasive. Personazhet e De Radës ndahen në personazhe reale dhe imagjinare. Pavarësisht nëse janë personazhët kryesorë apo dytësorë, te secili ekziston një mishërim i autorit në tipare të caktuara. Rina është tipizim i një fshatareje të edukuar në frymën e patriarkalizmit dhe i vajzave të klasës ku ajo përket. Përveç kësaj duket se është edhe idealizimi i autorit ndaj gruas që dashuron, ndaj nënës që kujdeset për të birin dhe ndaj vashës që di të dashurojë singërisht.

Nëna e Milosaos bart tiparet e gruas patriote, aristokrate e konservatore, ndërsa motra e Milosaos mund të konsiderohet si personazh i huazuar nga letërsia gojore. Tipizimi i saj bëhet me motrën e Gjergj Elez Alisë që po ashtu flijohet për të vëllanë, duke mos u martuar. Edhe pse arsyet dhe rrethanat dallojnë nga ato të këngës popullore, përsëri ka përputhje të dukshme të këtyre dy karaktereve që paraqesin edhe një pjesë të kolektivit shqiptar. E motra e Milosaos nuk është një karakter i plotë po një siluetë, mishërimi i një ideali, i dashurisë plot vetëmohim të motrës për vëllanë. (Kodra, 1990).

Ndërsa personazhi më i plotë i veprës është pa dyshim Milosao që paraqet edhe një pjesë të përjetimeve rinore të vetë De Radës dhe bota shpirtërore e të cilit është vazhdimisht e trazuar në mes dy pasioneve: atdheu dhe dashuria për Rinën. Konflikti psikologjik i Milosaos është i vazhdueshëm dhe pa një zgjidhje të prerë. Ndjenjat e sinqerta ndaj Rinës krijojnë ndjenjën e fajit ndaj atdheut.

Përveç luftës shpirtërore, atij i duhet të thejë edhe barrierat shoqërore dhe të rrënojë muret e ndërtuara mes shtresave shoqërore. Figura historike e Skënderbeut gjithashtu është e pranishme në poemë sepse ngjarja është e zhvendosur në kohën kur ai u printe luftërave për çlirim nga turqit. Milosao nisej pikërisht në luftën që udhëhiqej nga Skënderbeu.

Temat dhe motivet në poemë kanë ngjyrim atdhetar ashtu si ishte edhe synimi i Rilindjes Kombëtare. Mes letërsisë gojore dhe asaj të shkruar nga De Rada ekziston një harmoni e pakontestueshme dhe nuk cenohet autonomia e asnjërës, përkundrazi janë të gërshetuara mjeshtërisht duke u bërë kështu sinonim i vlerave estetike dhe artistike.

Përfundimi

“Këngët e Milosaos” mbetet një nga veprat më përfaqësuese të letërsisë arbëreshe, e cila gërsheton mjeshtërisht letërsinë popullore, vargun poetik dhe elementet mitologjike. De Rada me këtë poemë arrin të krijojë një vepër që tejkalon kufijtë kohorë dhe kulturorë, duke promovuar identitetin kombëtar dhe duke ruajtur trashëgiminë kulturore. Stili i poezisë popullore paraqet realitetin. Konkretizimin e botës artistike e bën me mjete të atilla, të cilat janë pjesë e rrethit të tij ndërsa raporti ndërmjet krijuesit dhe realitetit, i cili shpesh duket se është krejt identik ka bërë që poezia popullore në përgjithësi të ndërtohet me veçori stilistike të folklorit arbëresh.

Referencat

- [1]. Berisha, Rr. (1986). Stili dhe figuracioni i poezisë popullore shqiptare. Prishtinë: Rilindja.
- [2]. De Rada, J. (2007). Këngët e Milosaos. Shkup: Logos-A.
- [3]. Kodra, K. (1990). Poezia e De Radës. Prishtinë: Dukagjini.
- [4]. Rugova, I., & Hamiti, S. (1979). Kritika letrare. Prishtinë: Rilindja.